



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d dhe nenit 14, paragrafi 1 i Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 10, paragrafi 1.5 të Ligjit nr. 04/L-144, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 35/17 dhjetor 2012), nenit 20, paragrafit 11 të Rregullores QRK, nr. 23/2013, për përcaktimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, nenit 33.2, shkronja a), dhe nenit 34.1 shkronja d), të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 25.07.2017, merr këtë:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** propozimi i Kryetarit të Komunës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS), pa procedurë konkurrimi.
- II. Prona e paluajtshme që do të jepet në shfrytëzim ka këto karakteristika: parcela kadastrale nr. 285-0, Zona kadastrale Nëntë Jugoviq, me kulturë kullosë e klasës IV, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 3545 m², jepet në shfrytëzim sipërfaqja prej 15 m², e evidentuar si "pasuri shoqërore - Kuvendi Komunal Prishtinë".
- III. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale të përshkruar në pikën II të këtij propozimi, është vendosja e trafostacionit elektroenergjetik 10(20)/0.4K të ri me Sn=400kVA të tipit blinde.
- IV. Afati kohor për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës të përshkruar në pikën II të këtij vendimi, është për periudhë afatshkurtër për 15 vjet.
- V. Prona e paluajtshme komunale e përshkruar në pikën II të këtij vendimi, jepet në shfrytëzim pa kompensim.

- VI. Mënyra dhe kushtet e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe përfaqësuesit të shfrytëzuesit.
- VII. Prona e paluajtshme komunale që jepet në shfrytëzim, e përshkruar në pikën II të këtij vendimi duhet të evidentohet në librat kadastralë të Komunës.
- VIII. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Pronës dhe Drejtoria e Kadastrit e Komunës së Prishtinës.
- IX. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është skica gjeodezike.
- X. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

01. nr. 463/01-0182419/17, më 26.07.2017.



KRYESUESI I KUVENDIT
Halim Halimi, jur. i dpl.